

- 46 -

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 3 Date 06.04.2010

“PER
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TE POSACEM
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne piken 9, kreu XI, “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”, i vendimit nr. 87, dt. 16.01.2008 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, dhe nenit 18 germa dh, te ligjit nr.8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

- 1- MIRATIMIN e Autorizimit te posacem per Perdorim te Rezerves Ujore te Lumit Cemi i Selces, komuna Kelmend, rrethi Malesi e Madhe, per HEC Selce, Lumi Cemit, komuna Kelmend, rrethi Malesi e Madhe per HEC Tamare, Lumi Cemi Vuklit, komuna Kelmend, rrethi Malesi e Madhe per HEC Vukel, per prodhim hidroenergjie, Shoqerise “WTS ENERGJI ”sh.p.k. te privatizuara sipas Kontratave respektive nr. 307 Rep dhe Nr. 26 Kol. date 23.01.2004, Kontrate Nr. 2236 Rep dhe Nr. 193 Kol. dt. 11.07.2003 dhe Kontrate Nr. 2008 Rep nr. 27 Kol. date 23.01.2004, mbasi subjekti ka depozituar prane A.U.B. Drin-Bune kerkesen dhe kopjet e Kontratave te Shitjes se Pasurise Se Paluajtshme per HEC-et Selce, HEC Tamare dhe HEC Vukel., te ndertuara shume vite me pare.
- 2- Perdorimi i rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PERGJEGJESI I A.U.B.

DRIN-BUNE

Xhelal BAJRAKTARI



KRYETARI I K.B.U.

DRIN-BUNE

Maxhid CUNGU

